
	Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 50 (3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 Nëntorit 2017 që është rregullore udhëzuese mbi balancimin e energjisë elektrike	PR-MO-12
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 1 nga 13</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Barazimi Përfundimtar</i>


**PROPOZIMI I TË GJITHA TSO-VE KONTINENTALE EVROPIANE PËR
 RREGULLAT E PËRBASHKËTA TË BARAZIMIT PËRFUNDIMTAR PËR
 SHKËMBIMET E QËLLIMSHME TË ENERGJISË SI REZULTAT I PROCESIT TË
 RREGULLIMIT STABILIZUES TË FREKUENCËS DHE PERIODËS SË
 NDRYSHIMIT (RRITJE / ULJE) NË PËRPUTHJE ME NENIN 50 (3) TË
 RREGULLORES SË KOMISIONIT (BE) 2017/2195 TË 23 NËNTORIT 2017
 QË ËSHTË RREGULLORE UDHËZUESE MBI BALANCIMIN E ENERGJISË
 ELEKTRIKE**

	Përgatiti/Rishikoi	Kontrolloi	Aprovoi
Emri/Mbimri	Sherif Dedaqi	Safete Kelmendi	Skender Gjonbalaj
Nënshkrimi			
Data	22.02.2021	12.03.2021	15.03.2021

	Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 50 (3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 Nëntorit 2017 që është rregullore udhëzuese mbi balancimin e energjisë elektrike	PR-MO-12
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 2 nga 13</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori:Barazimi Përfundimtar</i>

Përmbajtja


Shkurtesat.....	5
Neni 1 Fushëveprimi dhe qëllimi.....	6
Neni 2 Përkufizime dhe interpretime.....	6
Neni 3 Përgjithësisht mbi rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar.....	7
Neni 4 Implementimi i barazimit përfundimtar të përbashkët.....	9
Neni 5 Funkcionet e barazimit përfundimtar të përbashkët.....	10
Neni 6 Perioda e barazimit përfundimtar	11
Neni 7 Përcaktimi i sasive të energjisë për periodë të barazimit përfundimtar TSO – TSO.....	11
Neni 8 Rregullat mbi çmimet për shkëmbimet TSO – TSO brenda SA CE	11
Neni 9 Publikimi dhe implementimi i CCFR.....	13
Neni 10 Gjuha.....	13

	Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 50 (3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 Nëntorit 2017 që është rregullore udhëzuese mbi balancimin e energjisë elektrike	PR-MO-12
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 3 nga 13</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori:Barazimi Përfundimtar</i>

TË GJITHA TSO-TË E EVROPËS KONTINENTALE, KONSIDEROJNË SI VIJON:

Duke marrë parasysh që


- (1) Ky dokument është një propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmisionit në Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale (në vijim referuar si "TSO të CE") në lidhje me zhvillimin e rregullave të përbashkëta të barazimit përfundimtar për të gjitha shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) (në tekstin e mëposhtëm "energji e procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe energji e periodës së ndryshimit (rritje / ulje)") në përputhje me Nenin 50 (3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 nëntorit 2017 për krijimin e një udhëzuesi për balancimin e energjisë elektrike (në tekstin e mëposhtëm "EBGL"). Ky propozim më poshtë quhet "**CCFR**", i cili nënkupton 'rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për Evropën Kontinentale për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje)'.
- (2) Ky CCFR merr parasysh parimet dhe qëllimet e përgjithshme të përcaktuara në EBGL si dhe Rregulloren (EC) Nr 714/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 Korrik 2009 mbi kushtet e qasjes në rrjet për shkëmbimet ndërkuftare të energjisë elektrike (më poshtë "**Rregullorja për Energjinë Elektrike**") si dhe Rregullorja (KE) Nr 2017/1485 e datës 2 gusht 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike (më poshtë referuar si "**SOGL**"). Qëllimi i EBGL është integrimi i tregjeve balancuese të energjisë elektrike. Integrimi i tregjeve balancuese të energjisë elektrike duhet të lehtësohet me krijimin e platformave të përbashkëta Evropiane për operimin e procesit të netimit të jobalanceve dhe mundësimin e shkëmbimit të energjisë balancuese nga rezervat e restaurimit të frekuencës dhe rezervat zëvendësuese. Bashkëpunimi midis TSO-ve duhet të kufizohet rreptësisht në atë që është e nevojshme për dizajnimin, zbatimin dhe funksionimin efikas dhe të sigurt të këtyre platformave Evropiane.
- (3) Nenin 50(3) dhe 50(8) të EBGL përcaktojnë afatin për dorëzimin për miratim e CCFR tek Rregullatorët Kombëtar dhe disa kërkesa specifike të tyre si vijon:
 3. Tetëmbëdhjetë muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të gjitha TSO-të që shkëmbejnë energji në mënyrë të qëllimshme në një zonë sinkrone duhet të zhvillojnë një propozim për rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar të zbatueshme për të gjitha shkëmbimet e qëllimshme të energjisë, si rezultat i një ose dy paragrafëve si në vijim:
 - (a) procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës sipas Nenit 142 të Rregullores (BE) 2017/1485;

	Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 50 (3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 Nëntorit 2017 që është rregullore udhëzuese mbi balancimin e energjisë elektrike	PR-MO-12
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 4 nga 13</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Barazimi Përfundimtar</i>

(b) periodës së ndryshimit (rritje / ulje) sipas Nenit 136 të Rregullores (BE) 2017/1485.

8. Të gjitha TSO-të do të krijojnë një mekanizëm të koordinuar për rregullimet (dhe korrigjimet) e barazimit përfundimtar ndërmjet tyre.


- (4) CCFR kontribon në josediskriminimin dhe transparencën e tregjeve balancuese në pajtim me Nenin 3 (1) (a) dhe Nenin 3 (2) (a) dhe 3 (2) (b) të EBGL, pasi që të njëjtat rregulla të barazimit përfundimtar do të zbatohen në të gjithë Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale dhe ato do të jenë në dispozicion të publikut.
- (5) CCFR kontribon në objektivën e rritjes së efikasitetit të tregjeve balancuese Evropiane dhe kombëtare, në përputhje me Nenin 3 (1) (b) të EBGL, duke qenë se programi i kompensimit zëvendësohet me rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar të zbatueshme për të gjithë Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale.
- (6) CCFR e plotëson kërkesën e nenit 3 (2) (h) të EBGL kështu që ky propozim bazohet në standardet evropiane të miratuara që tashmë janë në operim.
- (7) CCFR u zhvillua duke marrë parasysh konsistencën me rregullat e barazimit përfundimtar së shkëmbimeve të paqëllimshme të energjisë brenda Zonës Sinkrone të Evropës Kontinentale në përputhje me Nenin 51(1) të EBGL.
- (8) CCFR u zhvillua duke marrë parasysh konsistencën me rregullat e barazimit përfundimtar të shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë brenda zonave sinkrone në përputhje me Nenin 50(4) të EBGL dhe të shkëmbimeve të paqëllimshme në përputhje me Nenin 51(2) të EBGL.
- (9) Si përfundim, CCFR kontribon në objektivat e përgjithshme të EBGL.

	Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 50 (3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 Nëntorit 2017 që është rregullore udhëzuese mbi balancimin e energjisë elektrike	PR-MO-12
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 5 nga 13</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori:Barazimi Përfundimtar</i>

Shkurtesat

Lista e shkurtesave të përdorura në këtë CCU është si në vijim:

- ACE: Gabim i Zonës Rregulluese
- ACER: Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë
- ANES: programet e agreguara dhe të netuara të shkëmbimeve
- CCFR: rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për Evropën Kontinentale për shkëmbimet e energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje).
- CCU: rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për Evropën Kontinentale për të gjitha shkëmbimet e paqëllimshme të energjisë.
- EBGL: Rregullorja e Komisionit (BE) 2017/2195 e 23 nëntorit 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.
- Rregullorja e Energjisë Elektrike: Rregullorja (EC) Nr 714/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 korrik 2009 mbi kushtet për qasje në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike.
- Zona LFC: zona e rregullimit frekuencë-ngarkesë.
- Blloku LFC: blloku i rregullimit frekuencë-ngarkesë.
- SA CE: Zona Sinkrone e Evropës Kontinentale.
- SOGL: Rregullorja (KE) nr. 2017/1485 e datës 2 gusht 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.
- TSO: Operatori i Sistemit të Transmetimit.

	Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 50 (3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 Nëntorit 2017 që është rregullore udhëzuese mbi balancimin e energjisë elektrike	PR-MO-12
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 6 nga 13</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Barazimi Përfundimtar</i>

PARAQESIN PËR MIRATIM CCFR E MËPOSHTME TE AUTORITETET PËRKATËSE RREGULLATIVE:

Neni 1


Fushëveprimi dhe qëllimi

- (1) Rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për të gjitha shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) siç përcaktohet në këtë CCFR është një propozimi i përbashkët i të gjithë TSO-ve të SA CE në përputhje me Nenin 50(3) të EBGL.
- (2) Rregullat e mëposhtme të barazimit përfundimtar janë jashtë fushëveprimit të CCFR:
 - (a) rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimin e qëllimshëm të energjisë në pajtim me nenin 50 (1) të EBGL;
 - (b) rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimin e qëllimshëm të energjisë në pajtim me nenin 50 (4) të EBGL;
 - (c) rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimin e paqëllimshëm të energjisë në përputhje me Nenin 51(1) të EBGL;
 - (d) rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimin e paqëllimshëm të energjisë në përputhje me Nenin 51(2) të EBGL;
- (3) Administrimi, ndarja e kostos dhe vendimmarrja do të organizohen sipas kërkesave të EBGL dhe nuk janë brenda fushëveprimit të këtij propozimi.

Neni 2

Definicionet dhe përkufizimet

- (1) Për qëllimet e këtij CCFR, definicionet e përdorur do të kenë kuptimin e njëjtë me definicionet e përkufizuar me Nenin 2 të EBGL dhe në Nenin 3 të SOGL.
- (2) Në këtë CCFR do të përdorën edhe definicionet e mëposhtme:
 - (a) CCU i referohet 'Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e përbashkëta të barazimi përfundimtar për të gjitha shkëmbimet e energjisë të paqëllimshme në përputhje me Nenin 51 (1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 nëntorit 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike
 - (b) 'Energjia e rregullimit stabilizues të frekuencës' nënkupton energjinë që është importuar ose eksportuar nga çdo zonë LFC për periodën e barazimi përfundimtar TSO -TSO në përputhje me procesin e rregullimit stabilizues të frekuencës sipas Nenit 142 të SOGL. Energjia e procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës është e barabartë me integralin e gabimit të rregullimit të

	Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 50 (3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 Nëntorit 2017 që është rregullore udhëzuese mbi balancimin e energjisë elektrike	PR-MO-12
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 7 nga 13</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori:Barazimi Përfundimtar</i>

- frekuencës sipas Nenit 3 të SOGL për një periudë të barazimit përfundimtar ndërmjet TSO-TSO dhe korrespondon me shkëmbimet e qëllimshme të energjisë sipas Nenit 50(3)(a) të EBGL;
- (c) 'Energjia e periodës së ndryshimit (rritje/ ulje)' domethënë shkëmbimet e qëllimshme të energjisë sipas Nenit 50(3)(b) të EBGL dhe Nenit 136 të SOGL;
- (d) 'Perioda e barazimit përfundimtar TSO-TSO' nënkupton, në kontekstin e këtij CCFR, njësinë e kohës për të cilën llogariten shkëmbimet e paqëllimshme dhe shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje);
- (e) 'shkëmbimet e paqëllimshme të energjisë' janë të barabarta me integralin e gabimit të zonës së rregulluese (ACE) sipas Nenit 3 të SOGL për çdo periudë të barazimit përfundimtar TSO-TSO.
- (3) Në këtë CCFR, me përjashtim të rastit kur konteksti përshkruan të kundërtën:
- (a) Çmimet për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë jepen në EUR/MWh;
- (b) 'Evropa Kontinentale' dhe 'SA CE' nënkuptojnë Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale.
- (4) Gjithashtu, me përjashtim të rastit kur konteksti kërkon të kundërtën:
- (a) njëjësi tregon shumësin dhe anasjelltas;
- (b) tabela e përmbajtjeve dhe titujt vendosen vetëm për lehtësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e këtij CCFR;
- (c) çdo referencë në legjislacion, rregullore, direktivë, urdhër, instrument, kod ose ndonjë akt tjetër do të përfshijë çdo modifikim, zgjatje afati ose ri-miratim të tij në fuqi.
- (5) Barazimi përfundimtar sipas Nenit 3(8) dhe 3(9) të këtij CCFR duhet të përputhet me konventën e shenjave në Tabelën 1:


Tabela 1 Rrjedha e pagesës për barazimin përfundimtar të TSO-së sipas CCFR

	Çmimi i barazimit përfundimtar TSO-TSO: pozitiv	Çmimi i barazimit përfundimtar TSO-TSO: negativ
Sasia për periudë të barazimit përfundimtar të TSO: pozitiv (eksportet e TSO)	Pagesa për TSO	Pagesa nga TSO
Sasia për periudë të barazimit përfundimtar të TSO: negativ (importet e TSO)	Pagesa nga TSO	Pagesa për TSO


Neni 3

Përgjithësisht mbi rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar

- (1) Barazimi përfundimtar i përbashkët i kryer nga TSO-të e SA CE në pajtim me këtë CCFR do të përfshijë funksionin e llogaritjes, funksionin e barazimit përfundimtar të CCFR dhe faturimin.

	<p>Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 50 (3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 Nëntorit 2017 që është rregullore udhëzuese mbi balancimin e energjisë elektrike</p>	<p>PR-MO-12</p>
	<p>ver. 1.0</p>	<p>Faqe 8 nga 13</p>
<p>Departamenti: Operimi i Tregut</p>		<p>Sektori: Barazimi Përfundimtar</p>


- (2) Entiteti ose entitetet e ngarkuar me funksionin e llogaritjes së energjisë të CCFR do të mbledhin të gjitha të dhënat e kërkuara për të llogaritur energjinë e rregullimit stabilizues të frekuencës dhe energjinë e periodës së ndryshimit (rritje / ulje) për secilën periodë të barazimit përfundimtar TSO -TSO.
- (3) Inputet në funksionin e llogaritjes së energjisë të CCFR do të jenë:
 - (a) Vlera e raportuar e faktorit-k për zonën LFC të SA CE;
 - (b) Devijimi mesatar i frekuencës për çdo periodë të barazimit përfundimtar TSO -TSO të SA CE, i cili do të përcaktohet nga TSO e paracaktuar;
 - (c) të gjitha programet e agreguara dhe të netuara të shkëmbimeve (ANES) brenda SA CE.
- (4) Rezultati i funksionit të llogaritjes të CCFR do të jetë:
 - (a) Sasia e energjisë për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i periodës së ndryshimit (rritje / ulje) për çdo periodë të barazimit përfundimtar TSO -TSO brenda SA CE;
 - (b) Sasia e energjisë për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës për çdo periodë të barazimit përfundimtar TSO -TSO brenda SA CE.
- (5) Entiteti ose entitetet të cilave u është besuar detyra e barazimit përfundimtar CCFR do të mbledhë të gjitha të dhënat e kërkuara për të llogaritur çmimin për energjinë e shkëmbimit gjatë procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) për çdo periodë të barazimit përfundimtar TSO-TSO dhe do të llogarisë rezultatin financiar dhe rrjedhën e parasë për çdo bllok LFC ose zonë LFC.
- (6) Inputi i funksionit të barazimit përfundimtar CCFR do të jetë:
 - (a) sasia e shkëmbimit të energjisë të qëllimshme si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 7 të CCU;
 - (b) çmimin e tregut një ditë para të çdo Blloku LFC në SA CE në përputhje me Nenin 8(2)(a) të këtij CCFR;
 - (c) devijimin mesatar të frekuencës për secilën periodë të barazimit përfundimtar TSO -TSO të SA CE e cila përcaktohet nga një TSO e paracaktuar;
 - (d) Sasia e shkëmbimeve të paqëllimshme të energjisë në përputhje me Nenin 7 të këtij CCFR.
- (7) Funksioni i barazimit përfundimtar CCFR do të llogarisë të dhënat vijuese:
 - (a) Çmimin për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës për çdo periodë të barazimit përfundimtar TSO -TSO;
 - (b) rrjedhat financiare ndërmjet të gjitha blloqeve LFC ose zonave të LFC në SA CE si rezultat i shkëmbimit të qëllimshme të energjisë së procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës për çdo periodë të barazimit përfundimtar TSO -TSO.
- (8) Të gjitha sasitë e energjisë së periodës së ndryshimit (rritje / ulje) të llogaritura për çdo bllok LFC ose zonë LFC për çdo periodë të barazimit përfundimtar TSO -TSO, në përputhje me Nenin 7 të këtij CCFR, do të paguhen me të njëjtin çmim të llogaritur për atë periodë të barazimit përfundimtar TSO -TSO, në përputhje me Nenin 8(1) të këtij CCFR.

	Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 50 (3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 Nëntorit 2017 që është rregullore udhëzuese mbi balancimin e energjisë elektrike	PR-MO-12
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 9 nga 13</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Barazimi Përfundimtar</i>

- (9) Të gjitha sasitë e energjisë së rregullimit stabilizues të frekuencës të llogaritura për çdo bllok LFC ose zonë LFC për çdo periudë të barazimit përfundimtar TSO -TSO, në përputhje me Nenin 7 të këtij CCFR, do të paguhet me të njëjtin çmim të llogaritur për atë periudë të barazimit përfundimtar TSO -TSO, në përputhje me Nenin 8(2) të këtij CCFR.
- (10) Barazimi përfundimtar do të realizohet në nivelin e zonave rregulluese LFC përveç në rastet:
- (a) Kur të gjitha TSO -të e një bllokut LFC bien dakord që barazimi përfundimtar të bëhet në nivel të bllokut LFC; ose
 - (b) Disa TSO të një bllokut të vetëm LFC bien dakord që barazimi përfundimtar për zonat e tyre rregulluese të jetë i përbashkët.
- (11) Entiteti ose entitetet të cilave u është besuar detyra e faturimit duhet t'i faturojnë TSO-ve SA CE sipas rezultateve të funksionit të barazimit përfundimtar të CCFR.
- (12) Të gjitha TSO e SA CE do të pranojnë rrjedhat financiare të llogaritura dhe janë të detyruar të paguajnë sipas tyre. Rrjedhat financiare mund të rishikohen në rast se gjendet ndonjë gabim në llogaritje ose në të dhënat hyrëse në llogaritje.

Neni 4 Implementimi i barazimit përfundimtar të përbashkët

- (1) Të gjitha TSO-të e SA CE implementojnë rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar brenda 12 muajve pas miratimit të këtij CCFR, në përputhje me Nenin 5 (5) të EBGL.
- (2) Hapat e mëposhtëm dhe afatet kohore do të përdoren si udhërrëfyes për zbatimin e rregullave të përbashkëta të barazimit përfundimtar:
- (a) Përshtatja e të gjithë njehsorëve: Të gjithë TSO-të e SA CE të kenë ndryshuar pajisjet matëse të tyre dhe janë në gjendje të masin shkëmbimet e energjisë në periodën e barazimit përfundimtar TSO -TSO.
 - (b) Emërimi i entiteteve: Funksioni i llogaritjes të CCFR, funksioni i barazimit përfundimtar së CCU dhe detyrat e faturimit janë emëruar në një ose disa entitete sipas nenit 3 të CCU.
 - (c) Implementimi i funksionit të llogaritjes të CCFR: entiteti ose entitetet të cilave u është besuar funksioni i llogaritjes të CCFR. Të gjithë TSO-të e SA CE do të zbatojnë ndërfaqet e tyre me funksionin e llogaritjes së energjisë në kufi të CCFR nëse është e nevojshme.
 - (d) Implementimi i funksionit të barazimit përfundimtar së CCFR: entiteti ose entitetet të cilave u është besuar funksioni i barazimit përfundimtar së CCFR duhet të zbatojnë funksionin e llogaritjes së CCFR. Të gjithë TSO-të e SA CE do të zbatojnë ndërfaqet (interface) e tyre me funksionin e barazimit përfundimtar të CCFR nëse është e nevojshme.


	Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 50 (3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 Nëntorit 2017 që është rregullore udhëzuese mbi balancimin e energjisë elektrike	PR-MO-12
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 10 nga 13</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Barazimi Përfundimtar</i>

- (e) Implementimi i detyrave të faturimit të CCFR: entiteti ose entitetet të cilave u është besuar detyra e faturimit të CCFR duhet të zbatojnë detyrat e faturimit të CCFR. Do të konfigurohen të gjitha ndërfaqet e nevojshme.
 - (f) Testimi: Të gjitha TSO e SA CE do të testojnë ndërfaqet në Llogaritjen CCFR, funksionin e barazimit përfundimtar CCFR dhe nëse është e zbatueshme procesin e faturimit CCU.
 - (g) Operimi real: Nëse të gjitha testimet në përputhje me Nenin 4 (2) (f) të këtij CCFR do të jenë suksesshme, barazimet përfundimtare të përbashkëta do të fillojnë të zbatohen.
 - (h) Mekanizmi i rishikimit: Pas implementimit të këtyre rregullave të përbashkëta të barazimit përfundimtar, një mekanizëm shqyrtimi fillon nga fundi i vitit 2022, në të cilin TSO e SA CE do të shqyrtojnë CCFR. Një rishikim do të bëhet të paktën çdo tre vjet pas shqyrtimit të parë të duhur deri në fund të vitit 2022. Në mekanizmin e rishikimit, do të vlerësohet mundësia për evoluimin e çmimeve të balancimit në vend të çmimeve të tregut një ditë para. Përveç kësaj, mekanizmi i rishikimit mund të prekë, për shembull, parametrat e rregullave mbi çmimet të përshkruara në nenin 8 të këtij CCFR, por edhe detaje teknike si grumbullimi i të dhënave. Çdo ndryshim në CCFR duhet të dorëzohet nga autoritetet përkatëse rregullore për miratim.
- (3) Të gjitha funksionet e barazimit përfundimtar në pajtim me nenet 19-22 të EBGL do të marrin parasysh se vëllimet e shkëmbimeve të qëllimshme energjisë mund të duhet të dorëzohen në një zgjidhje tjetër kohore nëse ndryshohet perioda e barazimit përfundimtar TSO -TSO për energjinë e procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe ndryshimit (rritje / ulje) të energjisë.

Neni 5

Funksionet e barazimit përfundimtar të përbashkët

- (1) Barazimi përfundimtar i përbashkët në pajtim me këtë CCFR do të përbëhet nga funksioni i llogaritjes së CCFR dhe funksioni i barazimit përfundimtar së CCFR.
- (2) Qëllimi i funksionit të llogaritjes së CCFR do të jetë llogaritja e shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë si rezultat i periodës së ndryshimit (rritje / ulje) dhe procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës, për çdo periudë të barazimit përfundimtar TSO -TSO brenda SA CE, në përputhje me Nenin 3 të këtij CCFR.
- (3) Qëllimi i funksionit të barazimit përfundimtar së CCFR është llogaritja e çmimit të shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës për çdo periudë të barazimit përfundimtar TSO -TSO dhe të rrjedhave financiare midis të gjitha blloqeve LFC ose zonave LFC në SA CE si rezultat i shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë së procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës, në përputhje me Nenin 3 të këtij CCFR.

	Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 50 (3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 Nëntorit 2017 që është rregullore udhëzuese mbi balancimin e energjisë elektrike	PR-MO-12
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 11 nga 13</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori:Barazimi Përfundimtar</i>

Neni 6 Perioda e barazimit përfundimtar


- (1) Perioda e barazimit përfundimtar TSO -TSO është caktuar të jetë 15 minuta.
- (2) Perioda e barazimit përfundimtar TSO -TSO të çdo dite fillon menjëherë pas orës 00:00. Periodat e barazimit përfundimtar TSO - TSO do të jenë të njëpasnjëshme dhe jo të mbivendosura.

Neni 7 Përcaktimi i sasive të energjisë për periodë të barazimit përfundimtar TSO – TSO


- (1) Sasitë e shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës sipas Nenit 50(3)(a) të EBGL llogariten nga funksioni i llogaritjes i CCFR, për secilin bllok LFC ose zonë LFC për çdo periodë të barazimit përfundimtar TSO -TSO, si produkt i faktorit k të njohur dhe devijimit mesatar të frekuencës për atë periodë të barazimit përfundimtar TSO -TSO, në përputhje me Nenin 3 të këtij CCFR.
- (2) Sasitë e shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë si rezultat i periodës së ndryshimit (rritje / ulje) sipas Nenit 50(3)(b) të EBGL dhe Nenit 136 të SOGL llogariten me anë të funksionit të llogaritjes i CCFR për çdo bllok LFC ose zonë LFC dhe për periodën e barazimit përfundimtar TSO -TSO, në përputhje me Nenin 136 të SOGL.
- (3) Sasitë e shkëmbimeve të paqëllimshme sipas Nenit 51(1) të EBGL llogaritet me anë të funksionit të llogaritjes i CCU, për çdo bllok LFC ose zonë LFC dhe për periodën e barazimit përfundimtar TSO -TSO, në përputhje me CCU.

Neni 8 Rregullat mbi çmimet për shkëmbimet TSO – TSO brenda SA CE

- (1) Çmimi për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i periodës së ndryshimit (rritje / ulje) sipas nenit 50(3)(b) të EBGL është zero (0) EUR/MWh.
- (2) Çmimi për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë në përputhje me Nenin 50(3)(a) të EBGL do të llogaritet nga entiteti të cilës i është besuar funksioni i barazimit përfundimtar CCFR si shumë e komponenteve vijuese në EUR/MWh, për perioda të barazimit përfundimtar TSO -TSO:
 - (a) Komponenta e çmimit referent e llogaritur për çdo periodë të caktuar të barazimit përfundimtar TSO -TSO si çmim mesatar i ponderuar i tregut një ditë para të të gjitha blloqet LFC brenda SA CE për atë periodë të barazimit përfundimtar TSO -TSO, e ponderuar me vlerën absolute të shumës së shkëmbimeve të qëllimshme të energjisë në përputhje me Nenin 50 (3) (a) të EBGL dhe shkëmbimeve të paqëllimshme të energjisë sipas Nenit 51 (1) të EBGL, të secilit bllok LFC. Do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

	Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 50 (3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 Nëntorit 2017 që është rregullore udhëzuese mbi balancimin e energjisë elektrike	PR-MO-12
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 12 nga 13</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Barazimi Përfundimtar</i>

- i. Në rast se ka më shumë se një çmim të tregut një ditë para për bllokun LFC për atë periodë të barazimit përfundimtar TSO -TSO, çmimi mesatar i ponderuar llogaritet nga entiteti së cilës i është besuar funksioni i barazimit përfundimtar dhe përdoret në 8(2)(a) për bllokun përkatës LFC. Çmimi mesatar i ponderuar i një blloku LFC llogaritet duke ponderuar çmimet e tregut një ditë para të zonave LFC në atë bllok LFC me faktorin përkatës k të secilës zonë LFC. Nëse nuk ka çmim të tregut një ditë para në një zonë LFC brenda bllokut LFC, kjo zonë LFC nuk merret parasysh për llogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar të bllokut LFC.
 - ii. Në rast se ka më shumë se një çmim të tregut një ditë para në një zonë LFC për atë periodë të barazimit përfundimtar TSO -TSO, TSO që vepron në zonën LFC mund të vendosë se cilin çmim ose çmime do të përdorë për përcaktimin e çmimit të tregut një ditë para të zonës LFC.
 - iii. Në rast se nuk ka një çmim të tregut të ditës së mëparshme në një bllok LFC për atë periodë të barazimit përfundimtar TSO - TSO, çmimi i jobalancit për atë bllok LFC për atë periodë të barazimit përfundimtar TSO -TSO përdoret në Nenin 8(2)(a) në vend të çmimit të tregut një ditë para. Në rastin kur përdoren dy çmime të jobalanceve, llogaritet çmimi mesatar.
- (b) Komponenta e çmimit e varur nga frekuenca, e zbatueshme vetëm nëse vlera absolute e devijimit mesatar të frekuencës për periodën e barazimit përfundimtar TSO -TSO tejkalon vlerën absolute të vlerës minimale të pragut (20 mHz). Komponenta e varur nga frekuenca llogaritet si funksion i devijimit mesatar të frekuencës për secilën periodë të barazimit përfundimtar TSO - TSO, duke përdorur një gradient ndërmjet kufirit minimal dhe kufirit maksimal (dy (2) EUR/MWh/mHz). Do të zbatohen rregullat e mëposhtme:
- i. Vlera absolute e vlerës minimale të pragut është 20 mHz.
 - ii. Vlera absolute e vlerës maksimale të pragut është 100 mHz.
 - iii. Gradienti është dy (2) EUR/ MWh /mHz
 - iv. Në rast të një devijimi mesatar pozitiv të frekuencës që tejkalon vlerën minimale të pragut në drejtim pozitiv (+20 mHz), por që nuk tejkalon vlerën maksimale të pragut në drejtim pozitiv (+100 mHz), ky funksion zbatohet për devijimin mesatar të frekuencës të zvogëluar me vlerën absolute të vlerës minimale të pragut (20 mHz).
 - v. Në rast të një devijimi mesatar negativ të frekuencës që tejkalon vlerën minimale të pragut në drejtim negativ (-20 mHz), por që nuk tejkalon vlerën maksimale të pragut në drejtim negativ (- 100 mHz), ky funksion aplikohet në devijimin e frekuencës të rritur me vlerën absolute të vlerës minimale të pragut (20 mHz).
 - vi. Në rastin e një devijimi mesatar pozitiv të frekuencës që tejkalon pragun maksimal në drejtim pozitiv (+ 100 mHz), komponenta e varur nga frekuenca vendoset si

	Propozimi i të gjitha TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të rregullimit stabilizues të frekuencës dhe periodës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 50 (3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 Nëntorit 2017 që është rregullore udhëzuese mbi balancimin e energjisë elektrike	PR-MO-12
	<i>ver. 1.0</i>	<i>Faqe 13 nga 13</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Barazimi Përfundimtar</i>

komponentë e varur nga frekuenca e llogaritur në një devijim të frekuencës së vlerës maksimale të pragut në drejtim pozitiv (+ 100 mHz).

- vii. Në rastin e një devijimi negativ të frekuencës që tejkalon pragun maksimal në drejtim negativ (-100 mHz), komponenta e varur nga frekuenca përcaktohet si komponenta e varur nga frekuenca e llogaritur në një devijim të frekuencës së vlerës së pragut maksimal në drejtim negativ (-100 mHz).
- viii. Në rastin e një sistemi HVDC që lidh dy TSO SA CE, komponenta e varur nga frekuenca mund të mos jetë e zbatueshme.

- (3) Në rast se një ndarje të rrjetit me më shumë se një bllok LFC shkëputet, komponenta e varur nga frekuenca përcaktohet për çdo periodë të barazimit përfundimtar TSO -TSO gjatë asaj ndarje në zero (0) EUR/MWh/mHz për periodë të barazimit përfundimtar TSO-TSO.

Neni 9

Publikimi dhe implementimi i CCFR

- (1) Të gjithë TSO-të e SA CE do të publikojnë CCFR pa vonesa të panevojshme pasi të gjitha autoritetet rregullative relevante të SA CE të kenë miratuar CCFR e propozuar ose është marrë një vendim nga ACER në përputhje me Nenet 5 (7), 6 (1) dhe 6 (2) të EBGL.
- (2) Të gjitha TSO-të e SA CE duhet të zbatojnë CCFR në përputhje me Nenin 4 të këtij CCFR.

Neni 10

Gjuha

Gjuha e referencës për këtë propozim do të jetë gjuha angleze. Për shmangien e dyshimit, kur TSO-të duhet të përkthejnë këtë propozim në gjuhën e tyre kombëtare, në rast të mospërputhjeve midis versionit anglisht të botuar nga TSO-të në përputhje me Nenin 7 të EBGL dhe çdo versioni në një gjuhë tjetër, TSO-të, në përputhje me legjislacionin kombëtar, do t'u sigurojnë autoriteteve përkatëse kombëtare rregullatore një përkthim të përditësuar të propozimit.